



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 100  
Prishtinë, më 21.5.2024, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Bekim Arifi, Halil Thaqi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Yllëza Hoti, Rashit Qalaj, Hajdar Beqa dhe Albana Bytyqi.

**Munguan:** Visar Korencia dhe Adem Hoxha.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj.

**Pjesëmarrësit e tjerë:** Vlora Spanca AP, Beza Halilaj ZV. AP, Safet Berisha ZKA, Ramadan Gashi ZKA, Driada Thaqi ZKA, Erona Retkoceri, praktikante në Kuvend.

**Mbledhjen e kryesoi:** Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 7.5.2024;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2023;
5. Të ndryshme.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 7.5.2024

*Procesverbali u miratua pa ndryshime.*

## 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performances së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023. E ftuar: znj. Vlora Spanca, auditore e përgjithshme;

**Hykeme Bajrami, kryetare e Komisionit:** Të nderuar të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Sot kemi dy raporte nga ZKA-ja. Pika e tretë e rendit të ditës është Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023. E ftuar: znj. Vlora Spanca, e cila do ta paraqes raportin dhe të cilës ia kaloj fjalën.

**Vlora Spanca:** Faleminderit kryetare, të nderuar deputetë dhe ju të pranishëm. Faleminderit për ftesën për të bërë prezantimin e raportit vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023, i cili përmbledh rezultatet që ZKA-ja ka arritur nga aspekti i përmbushjes së objektivave funksionale, të ndërlidhura me mandatin e Auditorit të Përgjithshëm dhe Planin vjetor të auditimit, ashtu edhe menaxhimin financiar dhe administrativ. ZKA-ja ka arritur t'i përmbush të gjitha kërkesat dhe afatet ligjore për punën audituese me rezultatet përkatëse, duke kryer 124 raporte të auditimit të fushave financiare/pajtueshmërisë, si dhe të performancës. Po ashtu, është kryer vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve në të gjitha Organizatat Buxhetore. Pavarësisht sfidave të natyrave të ndryshme, në veçanti mbingarkesës së stafit, si rezultat i angazhimeve shtesë, për shkak të largimit të një numri të tyre. Plani vjetor i Auditimit për sezonin 2022/2023 është përmbushur sipas parashikimeve të bëra. Gjatë vitit 2023, janë kryer 107 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë të pasqyrave vjetore financiare, objektivë e të cilave ishte të ofrojmë siguri të arsyeshme, nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, si dhe të ofrojmë opinionin e auditimit, në lidhje me këto pasqyra. Përveç opinionit, ne kemi shprehur konkluzionin e auditimit për pajtueshmërinë me legjislacionin e zbatueshëm përkatës. Këto auditime kanë përfshirë të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë nivelin qendror, nivelin lokal dhe institucionet e pavarura, mandej një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve publike si dhe projektet e financuara nga donatorët. Përveç auditimeve financiare, gjatë vitit 2023, ZKA-ja ka kryer edhe 15 auditime të performancës, përmes të cilave ka promovuar efikasitetin, llogaridhënien, efektivitetin, vlerën për para dhe transparencën në administratën publike. Auditimet e performancës kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët dhe palët e tjera të interesit.

Fokus i auditimeve ishte: arsimi, shëndetësia, sporti, zhvillimi ekonomik, ujërat dhe mjedisi, teknologjia e informacionit, fusha e prokurimit publik. Po ashtu, duhet të theksuar që gjatë viti 2023, ZKA-ja ka kryer edhe dy 2 auditime me Informata të klasifikuara të nivelit e Kufizuar. Të nderuar deputetë, rezultatet kryesore nga Raporti Vjetor i Auditimit për auditimet e kryera gjatë vitit 2023, kanë nxjerrë në pah një numër dobësish në shumicën e organizatave buxhetore nëpër kategori të ndryshme, të cilat kanë rezultuar në menaxhim të dobët të fondeve publike si dhe mosarritjen e vlerës për para. Raportet e auditimit për vitin 2023, kanë identifikuar mangësi të ndryshme, disa prej të cilave mund t'i veçoj para jush, si: Në organizatat buxhetore- cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 86 auditimet e pasqyrave vjetore financiare, 33 sosh kishin keqdeklarime materiale, të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar/kualifikuar. Ndërsa, 53 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar, janë 13 organizata buxhetore më pak të cilat kanë marrë opinion të modifikuar. Përveç këtyre, ZKA-ja ka evidentuar çështje që lidhen me kontrollet dhe menaxhimin financiar si: Planifikim dhe realizim të buxhetit, rritje e llogarive të arkëtueshme, detyrimet e papaguara dhe kontingjente, pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore, si dhe pasuritë jofinanciare. Te Ndërmarrjet Publike-Cilësia e raportimit financiar edhe pse krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar, ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga 11 auditimet e pasqyrave financiare të këtyre ndërmarrjeve, vetëm në një është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa tek 10 të tjera opinion i modifikuar. Për sa i përket auditimeve të performancës, Teknologjisë së Informacionit dhe Prokurimit, edhe në këto auditime janë identifikuar mangësi në fusha me rëndësi ekonomike, shëndetësore, të mirëqenies sociale dhe prokurimit publik, që tregojnë për mungesën e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe mosarritjen e vlerës për para.

Gjatë vitit 2023 është vlerësuar zbatimi I rekomandimeve të vitit paraprak. Sipas këtij vlerësimi, 49% e rekomandimeve ishin zbatuar plotësisht, 9% pjesërisht dhe 42% nuk janë zbatuar. Sa i përket Menaxhimit financiar dhe administrativ të ZKA-së, raporti flet në mënyrë më të hollësishme lidhur me burimet njerëzore, zhvillimin profesional të stafit si dhe komunikimin dhe bashkëpunimin me publikun dhe palët e interesit. Dëshiroj të theksoj se auditimi për PVF-të e vitit 2023, është përfunduar nga kompania e kontraktuar nga Kuvendi dhe kam kënaqësinë të potencoj që opinionin është pozitiv (pa kualifikuar) dhe për herë të parë nuk ka asnjë gjetje të evidentuar në këtë raport. Buxheti final i ZKA-së ishte 3,052, 000 euro, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 2,876,000€, apo 94%. Pjesëmarrja me e madhe ishte në kategorinë e pagave dhe shtesave prej 75.5%, derisa në kategorinë e Mallrave dhe shërbime, në vlerë prej 22% të buxhetit, përfshirë edhe kategori të tjera të shpenzimeve komunale apo të investimeve kapitale që përfshijnë 2.5% të totalit të buxhetit. Krahas buxhetit final, kategoria e pagave dhe shtesave është shpenzuar 99%, Shërbimet Komunale 89%, Mallrat dhe Shërbimet 83% dhe Investimet Kapitale 50%. ZKA-ja në fund të vitit 2023 kishte 163 punonjës, prej tyre 79% personel auditues (përfshirë pozitat

drejtuese), dhe 21% janë punonjës të shërbimeve profesionale mbështetëse. ZKA-ja ka investuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit auditues për të siguruar që ata të jenë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e financave, auditimit dhe fushave tjera relevante. Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet tjera ligjore, ZKA-ja edhe gjatë vitit dhe 2023, fokus të rëndësishëm i ka dhënë trajtimit dhe adresimit të çështjeve më mundësi potenciale për mashtrim e korrupsion. Nga rezultatet e nxjerra në vitin 2023, kemi dërguar në Prokurori të Shtetit 51 raste me elemente potenciale të veprave penale, mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe 3 raporte të auditimit në tërësi. Ndërsa, nga viti 2018 kemi dërguar në Prokurori të Shtetit, mbi 300 raste me dyshime për mashtrim e korrupsion. Nga të gjitha këto raste, nga Prokurori i Shtetit në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit kemi pranuar informata kthyesë për 143 raste. Sipas këtyre informatave: janë ngritur vetëm 3 aktakuza, 81 raste janë në proces të hetimit dhe për 59 raste me raport të Prokurorit rastet janë mbyllur. ZKA-ja në vitin 2023, ka zhvilluar komunikim të frytshëm me palët e tjera të interesit, si dhe aktivisht ka qenë pjesëmarrëse në shumë takime, punëtori e konferenca, brenda dhe jashtë vendit. Në aspektin vendor është forcuar më tej partneriteti me komisionet parlamentare, për të cilën dëshiroj këtu në këtë seancë të ju falënderoj, si dhe me organizatat e shoqërisë civile. Kurse, në aspektin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi me Institucionet Supreme të Auditimit përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t, si dhe në nivel regional në kuadër të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për anëtarësim në BE. Dëshiroj të potencoj se ka vazhduar bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë, në fusha të ndryshme të zhvillimit institucional, me theks në fushën e auditimit të performancës dhe planifikimit strategjik po ashtu, ka vazhduar bashkëpunimin dhe me USAID-in. Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023 ka qenë subjekt i vlerësimeve të disa mekanizmave ndërkombëtarë karshi opinionit publik dhe karshi nivelit profesional dhe zbatimit të standardeve. Këto vlerësime zyrën tonë e kanë renditur shumë pozitivisht në nivel mjaftë të lartë të vlerësimit. Siç edhe jeni informuar më herët, vlerësimi më domethënës nga të gjitha ka qenë ai i rishikimit kolegjal i kërkuar nga ky Komision dhe i kryer nga ekspertë të pavarur të SIGMA-s, në shtator 2023. Shfrytëzoj rastin t'ju falënderoj juve si komision që keni ndërmarrë këtë iniciativë, që përveç që përmbush një kërkesë ligjore, me ka shërbyer mua si Auditore e Përgjithshme që të ndërmarrë masa për korrigjim. Siç e dini ky rishikim, ka vlerësuar se ZKA-ja është duke performuar në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira evropiane. Ky rezultat është angazhim i secilit udhëheqës e punonjës, se ZKA-ja për 20 vite dhe pa modesti e them se konkluzioni që jemi në pajtueshmëri me standardet, është si rezultat i vendimit tim për zbatimin e plotë dhe të pa kompromis të mandatit kushtetues dhe ligjor.

Edhe në vitin 2023, Indikatorët e besueshmërisë të matur nga Barometri Ballkanik i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal për vitin 2023, e nxjerrin serish ZKA-në e Kosovës si institucioni suprem i auditimit, që gëzon besimin më të lartë në nivel rajonal, me 55%. Po

ashtu, sipas vlerësimit të Sistemit të Integritetit Kombëtar në Kosovë, për vitin 2023 i realizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës, Zyra jonë është renditur institucioni me nivelin më të lartë të integritetit (me 83.3 nga 100 pikë). Këto rezultate janë një dëshmi e angazhimit të palodhur, transparencës dhe standardeve të larta etike dhe profesionale në të cilat ZKA-ja mbështet punën e vet. Ky vlerësim është domethënës dhe na inkurajon të kultivojmë edhe më tutje vlerat e larta dhe integritetin institucional. Të nderuar deputetë, dëshiroj t'ju informojë, se pas adresimit në Kuvend dhe Qeveri të Republikës së Kosovës, inicimin e procesit për plotësim/ndryshimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, si nevojë imediate me rrethanat e zhvillimit të fushës së auditimit në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht, tani ky projekt ligj është në planin legjislativ të qeverisë megjithatë, ende nuk kemi asnjë informacion rreth procesit. Krejt në fund, dua të shfrytëzoj rastin të theksoj para jush dy sfida kryesore më të cilat jam duke u ballafaquar, siç janë: çështja e objektit dhe ajo e largimit të stafit nga ZKA-ja. Zyra Kombëtare e Auditimit është e vendosur në një ndërtesë private, ndërsa kontrata e fundit për qira është nga gushti i vitit 2018 dhe skadon në janar të 2025. Përkundër shumë kërkesave të adresuara nga ana ime, akoma nuk është bërë zgjidhje për vendosjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit në një objekt/ndërtesë publike. Shqetësimi im kryesor është se një Institucion Suprem i Auditimit, i mandatuar për tu kujdesur për parane publike shpenzon një shumë të konsiderueshme të parasë publike në qiradhënie. Kjo përveç që zbeh kredibilitetin e institucionit tonë, paratë e dedikuara për qiradhënie do t'i ishin shfrytëzuar për rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Prandaj, kërkoj të bëhet një zgjidhje urgjente ngase kontrata me qiradhënësin përfundon në dhjetor të vitit 2024, në mënyrë që të shmangim pagesat enorme të qirasë, dhe në të njëjtën kohë të sigurojmë kushte më të përshtatshme për punë për punonjësit e ZKA-së.

Sfidë tjetër vazhdon të jetë largimi i stafit për shkak të pagave jokonkurrese me tregun. Siç e dini, për të ushtruar profesionin e auditorit, personelit i nevojiten njohuri dhe kompetencë përtej nivelit mesatar të nevojshëm në shumicën e profileve në institucione publike. Për të përmbushur këtë, ZKA-ja ka investuar dhe vazhdon të investojë në arritjen e këtij niveli, qoftë duke mundësuar certifikimin, por edhe edukimin e vazhdueshëm profesional. Përkundër kësaj, niveli i pagave për personelin e ZKA-së, viteve të fundit është duke pamundësuar ruajtjen e këtij stafi që të ofrojë kontributin e tyre në auditime. Vetëm gjatë vitit 2023 janë dorëhequr 11 punonjës, ndërsa në vetëm pesë mujorin e parë të vitit 2024, janë 5 punonjës të cilët kanë lëshuar ZKA-në. Ligji i Pagave në Sektorin publik, pavarësisht se ka qenë i mirëseardhur dhe bazë e mirë që njëherë e përgjithmonë të vendos një sistem të rregullt të pagave, ZKA-në, nuk e ka vendosur në nivelin e pritur. Në fund, dëshiroj që në emër timin personal dhe të ZKA-së, në përgjithësi të falënderoj Komisionin që ju e përfaqësoni për mbështetjen e pakursyer deri me tani për ZKA-në.

**Hykeme Bajrami, kryetare e Komisionit:** Faleminderit auditorë, për përmbledhjen dhe po e hapi diskutimin për deputetët e komisionit. Ne, që nga viti 2022 si Komision kemi

bërë kërkesë për një auditim të kontratave njëburimore në Ministrinë e Infrastrukturës, unë personalisht si përfaqësuese e grupit parlamentar të LDK-së kam kërkuar listën e kontratave njëburimore nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, dhe më është dorëzuar databaza e këtyre kontratave nga 22 mars 2021, deri 31 janar 2024. Nga kjo databazë vetëm në nivelin qendror, janë 781 kontrata në shumë prej 209 milionë euro, 668 kontrata janë kontrata të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë dhe 113 janë aneks kontrata në shumë prej 6.8 milion euro. Ju si ZKA, a mund të na jepni ndonjë shifër se sa mund të jetë numri i kontratave të prokurimit publik, në veçanti këto me negociim të drejtpërdrejt pa publikim të njoftimit për kontratë të cilat ZKA-ja i ka audituar.

**Vlora Spanca:** Sa i përket procedurës me negociim pa publikim ne kemi vërejtur se është bërë një dukuri negative si në nivelin lokal dhe atë qendror. Për të gjitha këto raste ne kemi raportuar në raportin vjetor të auditimit për vitin 2022, megjithatë jo me shifra por ne mund t'i sigurojmë për ju. Në aspektin e auditimit financiar të pajtueshmërisë, duke marrë parasysh rrezikun për keqpërdorimin e procedurës është në fokus të auditimeve, mirëpo, momentalisht nuk mund të ju jap shifër.

**Hykeme Bajrami:** Faleminderit auditore, ne e kemi të qartë sepse është neni 32 i Ligjit për prokurim publik, i cili i ka të specifikuara kriteret dhe kushtet se kur një Organizatë Buxhetore mund ta përdorë prokurimin publik, siç janë: të drejtat e autorit, pronësi industriale, kur ka vetëm një ofertues në treg, apo raste emergjente. Gjithashtu, ne jemi të vetëdijshëm që kontrata të tilla kanë ndodhur dhe më herët, por siç e thatë edhe ju, kjo dukuri është shtuar nga ana e Organizatave Buxhetore. Për periudhën 22 mars 2021, deri 31 janar 2024, janë 240 milionë euro, 209 milionë euro të nivelit qendror dhe 31 milionë të nivelit komunal. Kërkesa ime është që ju të bëni auditimin e të gjitha kontratave njëburimore, dhe të dalim me të dhëna të qarta, se kur Organizata Buxhetore kanë pasur arsyeshmëri për të ndërmarrë procedura të tilla me negociimi të drejtpërdrejt, dhe kur janë përdor pa arsyeshmëri, e cila sjellë dyshime të ndryshme të keqpërdorimit të parasë. Mbi të gjitha, ne jemi ekonomi e tregut të lirë dhe me këtë rast cenohet neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse kur negociacion me një dhe i anashkalon të tjerët deformon konkurrencën e lirë në treg. Ky është rekomandim i imi për këtë raport.

**Albana Bytyqi:** Faleminderit kryetare, dua të ju përgëzoj ju si ZKA për punën pasi që jeni vlerësuar dhe ndërkombëtarisht. Ju thatë se janë 124 raporte të përfunduara dhe të publikuara, por a janë të ndara, se sa raporte janë të nivelit qendror dhe sa të nivelit lokal? Ju si ZKA a keni pasur qasje në auditimin e procesit për furnizimin e rezervave shtetërore?

**Vlora Spanca:** Faleminderit për pyetjet, sa i përket raporteve të cilat i publikojmë, ne jemi me ligj të obliguar që të gjitha raportet a auditimit të cilat kryhen nga ZKA-ja të publikohen si për nivelin qendror dhe atë lokal. Janë 38 komuna, megjithatë auditimi për 4 komunat në veri të vendit nuk është kryer. Janë 11 raporte të auditimit për ndërmarrjet publike dhe 9 raporte të projekteve të financuara nga donatorët. Sa i përket auditimit të rezervave

shtetërore ne jemi në proces të auditimit për vitin 2023, nëse dosja është e klasifikuar në nivelin konfidencial, nuk kemi arritur të kryejmë auditimin e këtyre informatave për shkak të rrezikut pasi që niveli i sigurisë në një objekt privat është shumë i ulët, dhe sipas standardeve duhet të investojmë në një objekt për siguri më të lartë, për auditimin e informative të nivelit konfidencial.

**Hykeme Bajrami:** Nuk ka asnjë nen që kërkon konfidencialitet për dokumentacionin dhe rezervat shtetërore. Nëse merrni dhe e shikoni Ligjin për rezervën shtetërore, konfidenciale është mbajtja e rezervave, nuk është konfidenciale prej auditorit sepse janë një numër i zyrtarëve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe një numër i operatorëve privatë, të cilët e dinë se ku mbahen ato rezerva. Nëse institucionet ju thonë për diçka e cila është konfidenciale, ju si ZKA, u thoni se në bazë të cilit nen dhe ligj ky informacion është konfidencial. Nuk ka konfidencialitet në Ligjin për rezerva shtetërore. Në anën tjetër, sa i përket kushteve është e vërtetë se janë paguar 4 milion euro në vitin e fundit nga institucionet publike për objektet private në të cilat kryhet veprimtaria e disa institucioneve publike, kjo çështje duhet të zgjidhet për akomodimin e institucioneve publike në objektet përkatëse.

**Vlora Spanca:** Unë si auditore e përgjithshme, në momentin kur klasifikohet dokumenti apo informacioni konfidencial, nuk e marrim rrezikun për pranimin e atij dokumentacioni dhe t'i ofrojmë qasje auditorëve dhe të rrezikojmë të gjithë procesin. Sigurimi i një objekti publik dhe infrastrukturës publike dhe kushtet teknike, ku dhe mund të investohet në nivele të ndryshme për ZKA-në, atëherë do të kishim mundësi për të bërë auditimin e informatave konfidenciale, në këtë rast të resurseve shtetërore.

**Hykeme Bajrami:** Faleminderit auditore, fjalën e kaloj tek deputeti Rashit Qalaj.

**Rashit Qalaj:** Faleminderit kryetare. Përshëndetje për ju kolegë dhe për Zyrën Kombëtare të Auditimit. Në raportin vjetorë të performancës, u pa se është një numër i madh i raporteve të audituara, ku një numër i madh i organizatave buxhetore kanë rezultuar me raport të auditimit të pasqyrave financiare të klasifikuara. Nga 86 raporte, 32 janë të klasifikuara, që është mjaft shqetësuese. Kur shohim se cilat institucione kanë raport të klasifikuar atëherë është edhe më shqetësuese. Për mua nuk ka rëndësi nëse është institucion lokal apo qendror, por është institucion i qeverisjes së vendit, ku kanë raport të klasifikuar të pasqyrave financiare. Gjithashtu, te çështja e rekomandimeve të dhëna nga ZKA-ja, ku 571 institucione lokale dhe qendrore, vetëm 49% janë zbatuar, 9% pjesërisht, ndërsa gjysma nuk janë zbatuar fare. Shqetësim dhe papërgjegjësi serioze. Pozitive është që tek ndërmarrjet publike kemi ndryshim pozitiv, ku vetëm 3% e rekomandimeve nuk janë plotësuar, dhe duhet marrë shembull për zbatimin e rekomandimeve. Çështje tjetër është largimi i stafit, kjo është breng e çdo institucioni të Republikës së Kosovës, pasi që auditori i mirë është mjaft vështirë për t'u mbajtur, dhe largimi i fuqisë punëtore jashtë vendit për punësim është mjaft shqetësues. Sa i përket pyetjes së kryetares për kontrata të

negociuara, normalisht që e lejon ligji por vetëm në situata specifike, nuk është në pajtim me ligjin që me kontratë të negociuar pa publikim të blihen rrota të veturave për stinën e dimrit, në asnjë rast kjo nuk arsyetohet. E arsyetoj vetëm kohën e pandemisë, kur ka qenë emergjencë dhe nuk kemi pas mënyrë tjetër. Por, tani situatë të tillë nuk kemi. Kjo është shumë shqetësuese dhe nuk ka arsyetim. Kjo çështje është sensitive, në raportin e ZKA-së kishit dy raste të cilat i kishit audituar në raportin konfidencial, ne e dimë se raporti i rezervave është prioriteti i qeverisë dhe është problem për ZKA-në, por arsyetimi për objekt, sa i përket sigurisë nuk qëndron, pavarësisht objektit siguria duhet të jetë dhe pavarësisht nëse është dokumentacioni konfidencial, apo jo. Pajisja me certifikata të sigurisë për stafin e ZKA-së është punë mjaft e mirë e bërë nga ju. Çështja e rezervave shtetërore është temë e ndjeshme, por edhe e përsëritur, çështje e cila duhej të auditohej nga ZKA-ja deri më tani. Klasifikimi i rezervave shtetërore duke u thirrur në rregulloren e qeverisë për pajisje ushtarake është e kundërligjshme, për këtë çështje është duke u marrë prokuroria. Vetë fakti se është thirrur një rregullore dhe nuk është thirrur në ligjin për rezerva shtetërore, në ligjin për rezerva shtetërore vetëm një çështje është e klasifikuar, ajo e vendndodhjes dhe lokacionit ku janë të ruajtura rezervat shtetërore. Nuk është e lehtë fillimi i kësaj procedure të auditimit për ZKA-në, por është e nevojshme.

**Halil Thaqi:** Në këtë Kuvend kemi themeluar një komision hetimor për rezerva shtetërore, ku edhe deputeti z. Rashit Qalaj ka qenë kryesues i komisionit. Ne e dimë se nuk ka dal asgjë nga komisioni, ku deputet e partisë së LDK-së dhe PDK-së, kanë ardhur të bëjnë video për Tik- tok dhe për asgjë tjetër. LVV e ka bojkotuar për shkak të mosvotimit të marrëveshjes ndërkombëtare në Kuvend, por pas kësaj, ne kemi marrë pjesë vazhdimisht në Komisionin hetimor për rezervat shtetërore dhe asnjëherë nuk është arritur asgjë, pasi ka qenë mosmenaxhimi i tillë i komisionit dhe deputetët nga opozita, nuk e kanë marrë seriozisht punën në komision. Ka pasur një hetim parlamentar për rezervat shtetërore, por pa asnjë zgjidhje. Nga viti 2008 deri në vitin 2014, qeveria e udhëhequr nga PDK-ja, ka pasur 448 milionë euro kontrata të negociuara, në vitet 2015 – 2017, qeveria e udhëhequr nga LDK-ja, ka pasur 158 milionë euro kontrata të negociuara. Ju znj. Hykmete Bajrami kur keni qenë ministre, keni nënshkruar kontrata të negociuara dhe këtë e kam dëshmuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

**Hykmete Bajrami:** Dy koleget e mija kanë qenë pjesë e komisionit të cilin e përmendët. Komisionin hetimor për rezerva shtetërore, por LVV-ja e ka sabotuar sepse nuk ju ka konvencuar. Z. Thaqi ju nuk mund të dëshmoni asgjë sepse këto nuk janë të vërteta, asnjë kontratë njëburimore në karrierën time unë nuk e kam nënshkruar. Këto janë shpifje nga ana juaj. 158 milionë euro në tre vite qeverisje nuk janë të barabarta me 240 milionë në tre vite qeverisje. Unë nuk kam nënshkrimin tim, në asnjë kontratë njëburimore. Të gjithë ata që kanë nënshkruar kontrata njëburimore, pa arsyetim ligjor, pa u thirrur në nenin 32 dhe pa i përmbushur kushtet e atij neni, ai është vjedhës/hajdut.



**Mirlinda Tishukaj- Sadiku:** Mos e keqpërdor pozitën, sepse as ti s'ke të drejtë, pa fakte, ta quash dikë hajn. Çka të kam vjedhur unë? Në mandatin tënd janë avulluar 2 milionë euro. Qysh t'i ngjitet emri 2 milionshit. E jo të fyesh deputetin, duke i thënë shpifës.

**Hykmete Bajrami:** Për avullimin e 2 milionë eurove, hajnat janë në burg. Guvernator të Bankës Qendrore e keni bërë, ish- drejtorin e Thesarit, që ka qenë aty gjatë asaj vjedhjeje, andaj e pyetni guvernatorin, që e keni votuar në Kuvend, qysh ka qenë dhe qysh t'i ngjitet emri 2 milionshit të Thesarit.

**Halil Thaçi:** Kryesuese, ju lutem të mos e keqpërdorni pozitën në të cilën jeni, dhe ju lutem, të mos ofendoni, sepse jeni grua dhe nënë e dikujt dhe njëjtë si unë, që jam prind i dikujt, andaj mos fyej.

**Hykmete Bajrami:** Nuk jam duke keqpërdor pozitën aspak, vetëm dua të sqaroj se ju jeni duke shpifur me deklaratat e juaja. Dhe unë, Hykmete Bajrami, deputete e Republikës së Kosovës, nuk kam keqpërdorur dhe nuk kam vjedhur, ashtu siç ju po aludoni, drejtorin e Thesarit ju e keni bërë guvernator të Bankës Qendrore.

**Halil Thaçi:** Ju keni vjedhur 2 milionë euro dhe keni në pronësi barnatoret prej të cilave keni përfitime, ku të gjithë qytetarët e Kosovës janë në dijeni.

**Hykmete Bajrami:** Për shpifjet e barnatores, asnjë cent nuk kemi të investuar në pronësi të barnatoreve dhe për këtë çështje do të përballemi në gjykatë. Ju kërkohet që t'i ndalni këto informata, jo të sakta, drejtuar meje.

**Halil Thaçi:** Nëse është një ministër në Republikën e Kosovës, e cila ka bërë keqpërdorim të parasë, jeni ju znj. Hykmete Bajrami.

**Hykmete Bajrami:** Drejtori i Thesarit, i cili është guvernator i Bankës Qendrore, ju tregon se ku janë 2.1 milionë euro. Nuk ka asnjë dëshmi, sepse nuk i kam bërë këto keqpërdorime, të cilat ju jeni duke i thënë dhe këto janë shpifje, të cilat ju po i thoni. Jeni munduar të ma ndalni fjalën, por asnjëherë nuk do t'ia dilni.

**Halil Thaçi:** 158 milionë euro në periudhën 2015/2017, qeveria e udhëhequr nga partia LDK, ka nënshkruar kontrata njëburimore.

**Hykmete Bajrami:** Nëse keni dëshmi, mund t'i publikoni, por e vërteta është se ju nuk keni dëshmi, pasi që këto nuk janë të vërteta. Çdo kontratë e nënshkruar, pa i përmbushur kushtet e nenit 32 të ligjit të prokurimit publik, është vjedhje. 240 milionë euro janë në tri vitet e kësaj qeverie. Unë, personalisht, si ministre nuk kam nënshkruar asnjë kontratë njëburimore. Keqpërdoruesit e 2.1, milionshit në Thesar, janë të burgosur, për dallim prej rezervave shtetërore, për dallim nga Martin Berisha, për dallim nga z. Nagip Krasniqi. Drejtori i atëhershëm i Thesarit është guvernator, sikur ai të ishte kualifikuar për

keqpërdorim në Ministrinë e Financave dhe Thesarit, deputetët e partisë LVV, një person të tillë nuk do ta kishin bërë guvernator.

**Rashit Qalaj:** Sa herë që flasim për rezervat shtetërore, diskutimi ashpërsohet. Kur flasim për kontratat e negociuara pa publikim, në çfarëdo kohe që kanë ndodhur, nëse nuk janë në pajtim me ligjin dhe nuk janë plotësuar kushtet, janë dyshimet për keqpërdorime dhe kjo nuk e ndan asnjë vit. Ne po flasim për kontrata të negociuara pa publikim, të cilat i parasheh ligji. Por edhe aty, janë disa specifika se kur ajo kontratë nënshkruhet dhe nuk ndahen në vite. Situata është e tillë ku janë 240 milionë euro, kontrata njëburimore të nënshkruara në qeverinë e tanishme. Mirëpo, problemi është te rasti i cili duhet të auditohet, siç janë shpronësimet në fshatin Shipitullë, duhet të auditohet sesi ndërtohen shtëpi te familja Mjekiqi, kur atje është i ndaluar ndërtimi i shtëpive dhe pastaj shpronësohet. Duhet të hetohet përse mbillen 30 hektarë me arra dhe pastaj shpronësohen. Duhet të auditohet se si kontraktohet një individ, i cili nuk ka kompani për të bërë vlerësimin dhe cili është roli i tij me drejtorët, të cilët janë aktualisht në KEK dhe që janë nga ai rajon. Nëse po flasim për dukuri negative, duhet të auditohen të gjitha rastet, pa përjashtime. Ne si komision po kërkojmë me të drejtë, punë shtesë nga ZKA-ja, për t'i bërë këto auditime.

**Hajdar Beqa:** Faleminderit kryetare, të nderuar kolegë deputetë, zyrë e auditorit dhe të gjithë ju të pranishëm! Tema është mjaft e rëndësishme, fillimisht falënderojmë ZKA-në për punën që ka bërë në harmonizim me mandatin kushtetues dhe agjendën për periudhën 2023. E drejtë e jona, si komision, është të kërkojmë auditime shtesë. Ne po flasim për periudha konkrete, kemi menaxhim të dobët, duke u bazuar në raport, ku thuhet se janë 33 opinione të modifikuara, dhe 300 raste në prokurori, për shkak të keqmenaxhimit. Nga ato 300 raste, për 209 raste u dha një informatë për 91 raste nuk u dha informatë, janë ngritur 3 aktakuza, d.m.th. që ka vepër penale dhe 33 raste janë në proces. Nëse e shohim për vitin 2022 dhe shikojmë institucionet ku menaxhohet paraja publike, kanë qenë 571 rekomandime, 9 prej tyre janë pjesërisht të zbatueshme, 49% prej tyre janë zbatuar dhe 42% nuk janë zbatuar. Derisa e kemi këtë përqindje, situata është e rëndë. Problemi qëndron se çfarë ndodh mbas auditimit. Ju si auditorë e përfundoni një auditim, duke treguar se në një ndërmarrje publike apo ministri është keqpërdorur paraja publike dhe ka pasur shkelje të ligjit. Çfarë ndodh pas gjetjes së shkeljeve ligjore. Kur flasim për rezervat shtetërore, problemi është më i thellë, pasi që pas negociatave nuk kanë ardhur rezervat. E drejta jonë është të dimë se çfarë ka ndodhur. Sa i përket objektit, ju thatë se është sfidë, por dokumentet konfidenciale ju mundeni t'i shqyrtoni, po ashtu nuk është e nevojshme të merren dosjet dhe të dërgohen në objekt, pasi që ka edhe mënyra të tjera të qasjes. E drejtë e të gjithë qytetarëve është të dimë se çfarë ka ndodhur dhe po ndodh me parane publike. Auditore, ju përgëzoj për punën, por të njëjtën kohë e mbështes kryetaren e Komisionit, sepse ne kemi bërë kërkesë që për kontrata njëburimore, të bëhet një komision hetimor, të cilin mazhoranca nuk po e voton. Kërkojmë nga ju, të bëni auditimin dhe prokuroria të bëjë hetim, sepse kjo çështje është me interes publik. I njëjti problem qëndron edhe tek aneks-

kontratat. Ne kërkojmë angazhim më shumë nga ana juaj. Po shihet që keni edhe largim të stafit, për arsye të pagave. Të gjithë shërbyesit publikë dhe privat nuk paguhen aq sa e meritojnë. Në bazë të punës, të cilën e bëjnë, për këtë çështje duhet të punojmë bashkërisht, pasi që qytetarët nuk kanë interes të punojnë për një pagë të ulët në Kosovë, kur jashtë vendit mund të gjejnë punësim me pagë më të mirë. Nuk duhet që në komision të ashpërsohen debate, pasi që debatet janë më shumë për fushata elektorale, sesa për raportin e auditorit.

**Halil Thaçi:** Z. Hajdar, sa i përket rezervave shtetërore, ka pasur Komision hetimor për këtë çështje. Nëse ju dini diçka më shumë se prokuroria, është mirë që ju të drejtoheni tek ta.

**Hajdar Beqa:** Nuk është mirë t'i mbroni ata, të cilët bëjnë vepra të jashtëligjshme. Z. Ridvan, z. Martin Berisha, z. Faruk Mujka, z. Nagip Krasniqi, të gjithë këta persona janë aferë publike. Unë po kërkoj që institucionet t'i bëjmë më kredibile, pasi që qeveria dhe deputetët kanë mandatin e tyre dhe janë të zëvendësueshëm. Deputetët nuk zgjidhen duke mbrojtur të jashtëligjshmen.

**Halil Thaçi:** Deputeti Beqa, qytetarët janë ata të cilët e vendosin se kush do të jetë deputet. Dua të potencoj se qytetarët e kanë vendosur se nga komuna e cila unë kam vendlindjen, Obiliq, ju nuk keni degë të PDK-së. Sa i përket z. Nagip Krasniqi, do të dëshmohet se ai nuk është i përfshirë në afëra publike.

**Hajdar Beqa:** Z. Thaçi, ju kërkoj të mos e mbroni të keqen, sepse nuk iu bën nder. Kurse, sa i përket Komunës së Obiliqit, PDK ka qenë çdoherë stabile. Ndërsa, ju keni qenë ai, i cili keni shkuar te qindra familjarë, duke iu premtuar dhe mashtruar se do të punësohen në KEK, te z. Nagip Krasniqi dhe prapë nuk keni mundur të fitoni votat për kryetar të komunës.

**Halil Thaçi:** Ju lutem deputet, të mos bëni shpifje, sepse ne mund të flasim për shumë tema të tjera. Ne e dimë se kush ke qenë t'i, kur ishe drejtor i Hidrosistemit "Ibër- Lepenc".

**Hajdar Beqa:** Unë mburrem me të gjitha ato të cilat i kam bërë dhe ndihem i lumtur për të gjitha ato që kam pasur mundësi t'i bëjë për vendin dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Deputet z. Thaçi, ato shtëpitë, të cilat i përmendi deputeti z. Qalaj, të cilat janë ndërtuar tash për t'i vlerësuar, ju jeni ai i cili i keni ndërtuar së bashku me pemët, të cilat janë mbjellë për t'i vlerësuar.

**Halil Thaçi:** Këto janë shpifje dhe unë e ftoj prokurorin, që për çdo keqpërdorim që është bërë dhe të gjitha këto të cilat po i thua, do t'i dëshmosh në prokurori. E ftoj prokurorin ta marrë në intervistim z. Hajdar Beqa dhe z. Rashit Qalaj, për t'i treguar dëshmitë për ndërtimin e shtëpive. Fshati Shipitullë është zonë e ndaluar për ndërtimin e shtëpive.

**Hajdar Beqa:** Prokuroria gabon, nëse nuk iu dënon ju, z. Thaçi, për veprimet të cilat i keni bërë. Në fshatin Shipitullë, ju shkoni si përfaqësues i KEK-ut dhe përfaqësues i kompanisë së vlerësimit dhe jo si deputet. Ju jeni duke i manipuluar qytetarët.

**Vlora Spanca:** Mua më vije keq që u gjendëm para këtij debati, por unë po vazhdoj me përgjigjet për çështjet të cilat i ngriti z. Beqa, lidhur me raportin. Për çështjen e rasteve të cilat i kemi dërguar në prokurori, unë them që ne kemi një departament për çështje juridike dhe kundër mashtrimit, së bashku me një këshilltar ligjor, të dërguar nga USAID-i, ku së bashku e analizojnë secilin rast, nëse ka elemente potenciale për mashtrim, elemente të veprës penale për t'i dërguar të prokurori i Shtetit. Nga 300 raste, prokurori i Shtetit ka dërguar informacion për 143 raste, mirëpo fakti që janë ngritur vetëm 3 aktakuza, është nivel i ulët dhe 81 raste vazhdojnë të jenë nën hetim për rastet që nga viti 2018 e deri më tani. Për 59 raste, prokurori i ka mbyllur këto raste. Ne mendojmë se disa raste duhet të trajtohen më në thellësi dhe jemi duke organizuar punëtori, së bashku me prokurorin e shtetit, për t'iu dhenë më shumë informacione, që këto raste të trajtohen dhe të shqyrtohen më mirë dhe jo vetëm sipërfaqësisht. ZKA-ja lëshon rekomandime të auditimit dhe ne si institucion e kryejmë mandatin tonë dhe në baza vjetore e përcjellim zbatimin e rekomandimeve. I vetmi obligim ligjor i ministrave dhe kryetarëve të komunave është që të sjellin një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 30 ditësh, pas publikimit të raportit të auditimit dhe asnjë masë tjetër ndëshkuese, për moszbatim të rekomandimeve nuk ka në aspektin ligjor. Ne mundohemi të marim masa të ndryshme paraprakisht për parandalimin e gabimeve. Nuk ka një rritje të llogaridhënies dhe përgjegjësisë në institucione publike. Niveli i sigurisë, i cili kërkohet për dokumente konfidenciale, nuk është i duhuri, duhet të investojmë në objekt, edhe laptopët, të cilët mbajnë atë informatë, duhet të ruhen në lokacion, në të cilët kanë qasje vetëm personat e caktuar. Jam në pritje të vendimit për lëvizjen në një objekt publik me kushtet e nevojshme për kryerjen e funksionit. Kontratat e negociuara janë subjekt i auditimit financiar dhe pajtueshmërisë tek secili auditim, i cili kryhet në bazë të mostrave. Te çështja e ligjit të pagave kam dërguar një shkresë te Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe te tri komisionet parlamentare, përfshirë edhe Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Sa i përket OSHP-së, auditori i përgjithshëm e auditon në aspektin financiar dhe ka të drejtë të kryejë auditme të reja të performancës, megjithatë nuk kemi të drejtë të vlerësojmë meritokrancinë, të cilën OSHP-ja e nxjerr përmes vendimeve dhe e njëjta qëndron te sistemi gjyqësor.

**Hajdar Beqa:** Faleminderit auditore për sqarimet! Ju thatë se puna jonë përfundon kur dërgohen planet e veprimit dhe nuk kemi diçka tjetër nëse përsëriten të gjeturat e njëjta për 2-3 vite me radhë. Ne nuk e kemi arritur nivelin si institucione, duke filluar nga ne këtu, në tavolinë, që auditorin e brendshëm, jashtëm dhe Zyrës Kombëtare, t'i kemi ndihmesë, sepse nuk mund të bëhet menaxhim i mirë pa një auditim të drejtë, për të mos i përsëritur gabimet. Sa i përket pagave, është shqetësim i të gjitha institucioneve, pasi që kuadrot nuk

do të qëndrojnë me këto paga, duke marrë parasysh nivelin e inflacionit dhe nivelin e çmimeve që po rriten çdo vit.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Faleminderit deputet z. Beqa, fjalën e kaloj te deputetja e Komisionit, znj. Mirlinda Tishukaj-Sadiku.

**Mirlinda Tishukaj- Sadiku:** Faleminderit kryetare, edhe pse sot dole nga petku i kryetares, që duhet mbajtur nivelin, edhe ne mund të kemi frustrime dhe të dalim nga vetja, pavarësisht rrethanave. Më e pakta që ju mund të bëni është një kërkim falje, dhe keni përgjegjësi për fjalën publike, të cilën e thoni, pasi që na keni ofenduar në Kuvend. Unë kam dhënë mbështetje, si vet dhe si familje dhe vetëm se çfarë më takon me ligj, unë e marr. Ju duhet ta keni parasysh, si kryesuese e këtij komisioni, duhet të mundoheni të keni një qasje, që i takon një profesoreshe universitare dhe një deputete me shumë mandate. Sa i përket temës së kontratave të negociuara për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kemi qenë ne deputetë dhe jemi dakorduar për auditimin e atyre kontratave, madje është e vërtetë se kur ka qenë pikë e rendit të ditës në Kuvendin e Kosovës, ju keni munguar dhe nuk keni qenë prezent, edhe pse ZKA-ja i ka dhënë të drejtë pjesërisht jo për të arsyetuar askënd, sepse kanë qenë kontrata të trashëguara të viti 2018/19. Po e them si deputete e LVV-së, ne kemi qenë ata të cilët kemi iniciuar auditime në KEK, procedurat e prokurimit, në RTK. Ne kemi menduar të bëhet një afat më i gjerë i periudhave, të cilat duhet të auditohen, ndërsa opozita janë fokusuar për auditim të periudhës sa është qeveria Kurti 2. Së fundi, ZKA-ja ka publikuar raportin për E-Matura, 5.6 milion euro marrëveshje ndërkombëtare, ka kaluar me 80 vota të deputetëve në Kuvendin Kosovës, ndërsa sot nuk gjendet marrëveshja dhe ka shumë mangësi, kurse Kosova ka hyrë në obligim financiar. Çështja tjetër, lidhur me ndërtimin e stadiumit të Mitrovicës, e cila është kontratë e negociuar, me vlerë 12 milionë euro. Unë nuk jam kompetente dhe institucioni për t'i gjykuar për veprat e jashtëligjshme, nuk jam prokuror, gjykatës dhe as polic hetues. Në momentin kur kam dyshuar për çështje të caktuara, kam thënë se këtu po dyshoj dhe ftoj prokurorin për të bërë punën e tyre.

Auditore, ju përgëzoj për punën, raportet dhe jam dëshmitare në vizitën të cilën e kemi pasur në shtetin e Suedisë, që edhe ne si shtet i ri nuk qëndrojmë larg me një demokraci të avancuar, siç është në shtetin e Suedisë. Kjo më bën të ndihem mirë dhe jam mirënjohëse për bashkëpunimin dhe që na ofroni informacione të nevojshme. Pyetja ime lidhet me Komisionin për dhunën në familje. Ka qenë një debat të cilin e ka ngritur Instituti Kosovar për Demokraci, lidhur me auditimin e performancës, të cilin e keni bërë dhe ju keni evidentuar saktë mekanizimin, se ku nuk është duke funksionuar. Mirëpo, në raportin e auditorit e kam parë që, as gjykata dhe prokuroria në Prishtinë dhe Pejë, që i keni marrë si mostra, nuk kanë kthyer plan të veprimit. Sa i përket objektit, ne do ta marrim gjithë si përgjegjësi, sepse një institucion i tillë kushtetues, nuk është mirë të qëndrojë në një objekt të tillë. Ne do ta diskutojmë dhe si grup parlamentar, me ministrin, për një zgjidhje. Çështja e rekomandimeve tona, si komision, a keni mundur që të bëni një analizë se sa kanë qenë

adekuate dhe kompetente rekomandimet tona? Një çështje tjetër e rëndësishme në Kosovë, sa i përket ndërtimeve të shumta, ju keni pasur mostër vetëm Prishtinën, a do të zgjerohet auditimi në vitet në vazhdim, për 5 rajonet kryesore të Kosovës, të dimë se ku gjinden komunat tjera në këtë aspekt? Sa i përket ligjit të pagave, çdo institucion po ka problem, sidomos me IT-në. Ju keni bërë një auditim paralel me Tiranën. Si qëndrojmë me shtetin amë në aspektin kualitativ, a keni vërejtur ndonjë ndryshueshmëri, një qasje më ndryshe, shkëmbim të përvojave e tjera? Faleminderit dhe ju përgëzoj për punën, shëndet dhe punë të mbarë!

**Vlora Spanca:** Faleminderit për vlerësimin ndaj punës së ZKA-së. Lidhur me çështjen e vlerësimit apo raportin të cilin e ka nxjerrë Instituti Kosovar për Drejtësi, ne kemi audituar raste për dhunë në familje dhe kemi përfshirë dy gjykatat themelore, për të vlerësuar në aspektin e efikasitetit dhe jo atë të cilësisë së vendimmarrjes. Pa e diskutuar meritokracinë e vendimeve, të cilat gjyqësori i merr. Andaj, kemi mospajtime, në aspektin e kompetencave të auditorit.

**Mirlinda Tishukaj-Sadiku:** Gjatë vizitës në shtetin e Suedisë, kam parë raporte të tilla të performancës të publikuara në faqen zyrtare. Si ka mundësi ta adresojmë këtë çështje, që mos të kemi interferencë, sepse ligji nuk ndryshohet çdo ditë? A mendoni se mund ta adresojmë me ligj?

**Vlora Spanca:** Ligji për auditorin e përgjithshëm në ZKA, thotë qartë se autori përgjithshëm kryen në baza vjetore auditime të detyrueshme të rregullsisë të organizatave buxhetore të Kosovës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, e ka një kod organizativ. Ligji i auditorit të përgjithshëm, thotë se përveç auditimeve të cekura më lart, në organizatat të cilat janë të lisuara më lartë, ka të drejtë të kryejë auditime të tjera, se çka janë auditime të tjera, ligji e specifikon se cilat janë ato lloje të auditimeve të tjera, që janë auditime të performancës. Unë, si auditore e përgjithshme, nuk e kam asnjë dilemë të vetme, që auditori i përgjithshëm ka kompetencë të auditojë efikasitetin, efektivitetin e sistemeve, aktiviteteve dhe programeve, në kuadër të institucioneve publike dhe në përputhje me këtë është kryer auditimi. Unë kam biseduar edhe me INTOSAI-në, që është Organizata Ndërkombëtare për Institucione Supreme të Auditimit dhe ata janë të gatshëm, që në rast se ka dilema të tilla, lidhur me mandatin e auditorit të përgjithshëm në sistemin e drejtësisë, të ofrojë një sqarim, për shkak se këto janë praktika, të cilat përdoren edhe nga zyrat kombëtare të auditimit në nivel ndërkombëtar. Një dilemë është tek gjyqësori, për shkak se është njësia për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve. Auditori i përgjithshëm, në asnjë mënyrë, nuk kryen vlerësimin e performancës së asnjë zyrtari. Sa i përket cilësisë së rekomandimeve të auditimit, të lëshuara nga ky komision, ne jemi në proces të finalizimit të auditimeve për vitin 2023 dhe nëse kjo është kërkesë e juaja, ne mund ta bashkëbisedojmë me personat, në kuadër të zyrës sonë dhe të shohim nëse rekomandimet të cilat i keni dhënë, janë të matshme, janë të zbatueshme, janë të arritshme apo mos kemi dyfishim të rekomandimeve. Lejet e ndërtimit të lartë, është një temë e cila është propozuar

nga auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ka më shumë se 2 vite që kemi diskutuar, megjithatë duke marrë parasysh kompleksitetin e temës, është dashur të sigurohet fillimisht një ekspertë i fushës. E kemi angazhuar tashmë një ekspertë të fushës, te lejet e ndërtimit dhe po ashtu e kemi vendosur nën monitorim të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, për shkak të ndjeshmërisë dhe kompleksitetit. Auditimi është në proces, pas përfundimit të këtij auditimi. Ne do t'i shohim mundësitë e zgjerimit edhe në komunat tjera. Sa i përket raportit me Tiranën, raporti ka vënë në pah se qëndrojmë njëjtë në aspektin e cilësisë dhe sigurisë së informacionit.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Faleminderit shumë auditore! E ngrite çështjen e Ligjit për ZKA-në, ne në fillim të mandatit, si Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kemi qenë të gatshëm që ta bëjmë ne si deputetë, ndërsa pas diskutimeve, u zgjodh që ta sponsorizonte qeveria. Sa i përket çështjes së ndërtesave të institucioneve publike, të cilat marrin me qira ndërtesa private, në fakt në raportet vjetore të Ministrisë së Financave del që 34 milionë, në vitet e fundit u janë paguar operatorëve privatë, për ndërtesa të qirasë dhe për këtë deputetët nuk mund të bëjnë zgjidhje. Në fakt, kemi provuar t që t'iu ndihmonim përmes amendamenteve buxhetore, me blerje të veturave dhe kemi diskutuar koeficientin për autorët, por pa sukses, për shkak të qeverisë, d.m.th. këto janë gjëra që ne si komision jemi munduar t'i bëjmë. Unë, si kryetare dhe anëtare e Komisionit, kam një propozim për anëtarët e Komisionit, që t'ju bëjmë një kërkesë, që t'i auditoni të gjitha kontratat njëburimore. Unë i kam të dhënat, siç e thashë, për tre vitet e fundit. Nëse doni, kthehemi edhe në vitet e mëhershme, pa asnjë problem.

**Vlora Spanca:** Çdo kërkesë e cila ka ardhur nga ky Komision, e kemi marrë me seriozitet edhe përkundër kapaciteteve të limituara për auditime të performancës. Megjithatë, duhet ta sqaroj, se në bazë të ligjit për auditorin të përgjithshëm, është në diskrecion të vendosë, kur dhe çka të auditojë, pavarësisht nëse është kërkesa e Kuvendit të Kosovës. Ne nuk bëjmë kontroll 100%. Ne ofrojmë siguri të arsyeshme për sistemin, sepse auditimi nuk e ka për obligim nxjerrjen e mangësive që ekzistojnë në sistem, por e ka obligim të nxjerrë një siguri të arsyeshme se si funksionon sistemi. Në rast se ju e dërgoni periudhën, edhe periudha mund të shqyrtohet nga ana jonë, në bazë të kapaciteteve të cilat i kemi, mirëpo jo të gjitha, çka do që ka në sistem edhe auditohet, sepse është një metodologji që duhet të respektohet.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Auditore, ju pastaj e zgjidhni përmes metodës dhe mostrës, mirëpo edhe në mesin e kontratave ka disa që janë komplet të arsyeshme. Kërkesa ime është që të hedhet në votim për auditimin të të gjitha kontratave njëburimore, për tre vitet e fundit.

**Halil Thaçi:** Ne kërkojmë të bëhet auditimi i kontratave njëburimore për një periudhë 10-vjeçare.

**Hykmete Bajrami:** Në rregull, për mua nuk është asnjë problem, mund ta hedhim në votim, auditimin e kontratave njëburimore, për nivelin qendror dhe lokal, për periudhën 10- vjeçare. Kush është për?

#### *Përfundim*

*Propozimi për auditimin e kontratave njëburimore, për nivelin qendror dhe lokal, për periudhën 10- vjeçare, nuk i kishte votat e mjaftueshme për votim.*

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** E kam analizuar me kujdes raportin e shpenzimeve të buxhetit të Republikës së Kosovës për 2023. Nuk e di nëse e keni përfunduar auditimin, por diçka që kam vërejtur është se në vitin 2021-2023, janë 520 milionë subvencione për entitete publike. Vetëm në vitin 2023, janë 195 milionë subvencione për entitete publike. Në vitin 2019, kjo ka qenë rreth 61 milionë subvencione për entitete publike. Struktura e buxhetit ka ndryshuar drastikisht, në krahasim me vitet e kaluara, vetëm 11% e buxhetit ka shkuar në investime kapitale, janë rritur avancat për investime kapitale. Në vitin 2023, 60 milionë, sipas raportit të Ministrisë së Financave, janë avancë për investime kapitale. Mesatarja e viteve tjera, para kësaj qeverie, ka qenë 4 milionë. Në vitin 2023 janë shpenzuar 139 mijë euro në telefona. 34 milionë euro janë shpenzuar për qira, 3.2 milionë euro janë shpenzuar në vitin 2023, për dreka. Gjithashtu, blerjet e mobileve 3.1 milionë euro. Prandaj, e shfrytëzova rastin këtu, që të kemi vëmendjen, sepse më të vërtetë duket që janë shpenzime jo të arsyeshme.

#### **4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2023**

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Pika e katërt e rendit të ditës, shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2023, e kemi parë raportin dhe nuk ka të gjetura. Fjalën e kaloj tek auditorja e përgjithshme, nëse keni diçka për të shtuar.

**Vlora Spanca:** Faleminderit kryetare! Opinioni i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023, është opinion i pamodifikuar dhe sa i përket çështjeve, nuk kemi pranuar ndonjë çështje me letër-menaxhment nga kompania private. Kanë qenë 3 milionë euro buxhet final për shpenzim, dhe prej tyre, ne kemi shpenzuar 94% të buxhetit, ndërsa 75% ka qenë te pagat dhe mëditjet. Pjesa tjetër është mallra dhe shërbime, ku pjesën më të madhe e merr qiraja për objektin e zyrës.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Faleminderit auditore! Ju keni pasur kërkesa për disa vetura në fillim të vitit, kur është planifikuar buxheti, pastaj kemi parë që gjatë



vitit, Agjencia Qendrore e Prokurimit, e ka shpallur një tender për marrjen e veturave me qira 7-9 milionë euro. A jeni ju institucioni, i cili keni përfituar ndaj atij prokurimi?

**Bezad Halilaj:** Faleminderit kryetare! Sa i përket çështjes së veturave, nuk ka më shumë se 10 ditë, ku ne kemi marrë informacionin prej AQP-së, për llojin e veturës, të cilin e kemi kërkuar në vitin 2023 dhe është miratuar kontrata. Ne kemi përfituar vetëm një veturë, ashtu siç e kemi kërkuar, për shkak të buxhetit.

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Faleminderit shumë Zyra Kombëtare e Auditimit, për prezencën dhe sqarimet për këtë Komision.

## 5. Të ndryshme

**Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit:** Kemi pikën e 5-të të rendit të ditës, ku është dashur të vendosim për adresimin e mëtutjeshëm të disa raporteve. Por në mungesë të kuorumit, po e mbyllim këtë mbledhje të KMFP-së.

Për takimin e radhës do të njoftoheni me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Hykmete Bajrami,**

---

**Kryetare e Komisionit**